



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

V E N D I M

NR. 11, DATË 30 / 12 / 2025

PËR

DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 23, DATË 30.12.2024 TË KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE, “PËR MIRATIMIN E STATUSIT INVESTIM/INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË” PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “RESORTI TURISTIK – ISHULLI I SAZANIT” PROPOZUAR NGA SUBJEKTI “ATLANTIC INCUBATION PARTNERS LLC” SHOQËRI E TË DREJTËS AMERIKANE ME NR. IDENTIFIKIMI (EIN) 92-3329707

Në zbatim të neneve 8, 9, 17, 18, 22, 25, 27, 30 dhe 31, të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Kreut II, pika 8 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1030, datë 16.12.2015 “Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e Fondit të Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS)” Komiteti i Investimeve Strategjike, me propozim të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA),

VLERËSOI:

- Projekti i investimit strategjik “Resorti Turistik – Ishulli i Sazanit”, ka përfituar statusin investim/investitor strategjik me vendim nr. 23, datë 30.12.2024. Miratimi i projektit të integruar turistik, kushtëzohej me realizimin e detyrave, planit të veprimit të parashikuar në këtë vendim, si dhe me finalizimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis palëve, të vlefshme miratuar me ligj të veçantë në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.
- Në kuadër të realizimit të projektit të investimit “**Resorti Turistik – Ishulli i Sazanit**”, Komiteti i Investimeve Strategjike ka përcaktuar mënyrat, procedurat, afatet dhe organet zbatuese për ofrimin e asistencës së nevojshme, sipas planit të veprimit që i bashkëlidhet Vendimit nr. 23, datë 30.12.2024.

- Plani i veprimit, i miratuar me Vendimin nr. 23, datë 30.12.2024 të Komitetit të Investimeve Strategjike, nuk u realizua plotësisht brenda afateve të përcaktuara, për shkak të kompleksitetit të projektit, të evidentuar për arsye teknike, procedurale dhe ligjore, të lidhura si me angazhimet e institucioneve shqiptare, ashtu edhe me angazhimet e ndërmarra nga subjekti përfitues i statusit.
- Sipas afateve të parashikuara në vendimin e KIS, Grupi i Negocimit të Marrëveshjes zhvilloi gjithsej 10 (dhjetë) mbledhje, gjatë të cilave u realizua pjesa më e madhe e detyrave të caktuara nga Kryetari i KIS.
- Në kuadër të këtyre 10 mbledhjeve, u realizua fillimisht nënshkrimi i një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet subjektit “Atlantic Incubation Partners LLC”, Korporatës Shqiptare të Investimeve dhe shoqërisë Albanian Seaport Development Company sh.a, në të cilin u përcaktuan parimet bazë të bashkëpunimit për realizimin e marrëveshjes përfundimtare.
- Korporata Shqiptare të Investimeve, krijoi shoqërinë që do të hyjë në marrëdhënie juridike me subjektin përfitues të statusit Atlantic Incubation Partners LLC.
- Korporata Shqiptare e Investimeve, ka siguruar ekspertizën e nevojshme me qëllim forcimin e pozitave të shtetit shqiptar në procesin negociues.
- Ministria e Mbrojtjes, arriti të evidentojë kostot për pastrimin e zonës nga rreziku piroteknik, si dhe të inventarizojë të gjitha asetet dhe pasuritë e ndodhura në Ishullin e Sazanit.
- Ministria e Mbrojtjes, ka regjistruar të gjitha pasuritë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.
- Grupi i Negocimit të Marrëveshjes (GNM), konfirmon se është zhvilluar një proces dypalësh negociues intensiv dhe gjithëpërfshirës, por për shkak të kompleksitetit jo vetëm të projektit, por edhe të situatës infrastrukturore aktuale të gjurmës së projektit, i propozon Komitetit të Investimeve Strategjike shtyrjen e afateve të negocimit me subjektin përfitues të statusit strategjik.
- Procedura e vlerësimit të projektit bazohet në nenin 25 të Ligjit nr. 55/2015, të ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike” dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1030, datë 16.12.2015 “Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin dhe administrimin e Fondit të Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS)”.

- Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDOSI:

1. Pika 20 e Vendimit të KIS Nr. 23, datë 30.12.2024 ndryshon si më poshtë:

Ngarkohet Ministria përgjegjëse për Turizmin dhe Bashkia Vlorë për përfshirjen e sipërfaqeve bregdetare në listën e stacioneve të plazhit në Ishullin e Sazanit brenda 20 ditëve pune nga njoftimi i këtij vendimi nga Sekretariati Teknik.

2. Pika 23 e Vendimit të KIS Nr. 23, datë 30.12.2024 ndryshon si më poshtë:

Ngarkohet Ministria përgjegjëse për Ekonominë për propozimin në Këshillin e Ministrave të vendimit për konsolidimin e pronës dhe kalimin e aseteve në pronësi të Korporatës Shqiptare të Investimeve, në cilësinë e entitetit publik që siguron pjesëmarrjen shtetërore në investim, sipas dispozitës 9/c të këtij vendimi, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve pune, nga njoftimi i këtij vendimi nga Sekretariati Teknik.

3. Pika 24 e Vendimit të KIS Nr. 23, datë 30.12.2024 ndryshon si më poshtë:

Ngarkohet Ministria përgjegjëse për Infrastrukturën dhe Ministria përgjegjëse për Mbrojtjen për caktimin e kushteve tekniko - ligjore për zhvillimin dhe përdorimin e marinës turistike nga ana e investitorit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve pune nga njoftimi i këtij vendimi nga Sekretariati Teknik.

4. Pika 28 e Vendimit të KIS Nr. 23, datë 30.12.2024 ndryshon si më poshtë:

Ngarkohet subjekti përfitues i statusit të dorëzojë dokumentacionin e listuar në pikën 11 të këtij vendimi, brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve pune, nga njoftimi i këtij vendimi nga Sekretariati Teknik.

5. Pika 31 e Vendimit të KIS Nr. 23, datë 30.12.2024 ndryshon si më poshtë:

Ngarkohet Ministria përgjegjëse për Mbrojtjen në ndjekjen dhe realizimin e proceseve për krijimin e kushteve të nevojshme procedurale dhe fizike me qëllim pastrimin e zonës nga risku piroteknik, kostot e të cilave do të mbulohen nga vetë ministria.

6. Shkronja b), pika 34 e Vendimit të KIS Nr. 23, datë 30.12.2024 ndryshon si më poshtë:

brenda 120 (njëqind e njëzetë) ditëve pune nga njoftimi i këtij vendimi, të negociojë me subjektin investues projektin e parashikuar në pikën 14 /(b) dhe (c) të këtij vendimi. Ky afat mund të shtyhet me 120 (njëqind e njëzetë) ditë të tjera pune me dakordësi të palëve.

7. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet investitorit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR I EKONOMISË DHE INOVACIONIT

DELINA IBRAHIMAJ

MINISTËR I FINANCAVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR I TURIZMIT KULTURURËS DHE SPORTIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

ANDIS SALLA

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

ODISE MOÇKA

SEKRETARIATI TEKNIK I KIS

LAURA PLAKU (SARO)